



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1493/11 Prot.

Tiranë, më 04.10.2022

VENDIM

Nr. 76, datë 04.10.2022

PËR  
MIRATIMIN E NJË SHTESE NË  
RREGULLOREN E REKRUTIMIT TË PERSONELIT ADMINISTRATIV NË UST

Mbështetur në nenin 38, gërma “d” të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e Senatit Akademik nr.66 datë 23.04.2021 “Për miratimin e rregullore së rekrutimit të personelit administrativ të UST, lëvizjet paralele për stafin administrativ”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 04.10.2022

VENDOSI:

1. Të bëhet shtesë në rregulloren e rekrutimit të personelit administrativ tek paragrafi, Lëvizjet Paralele, si më poshtë vijon:

Lëvizjet e brendshme të stafit ndihmës akademik në staf administrativ (lëvizjet paralele) bëhen pa konkurim nëse plotësojnë kriteret për pozicionin e lirë. Këto lëvizje të brendshme propozohen nga Administratori bazuar në nevojat e drejtorive dhe miratohen nga Rektori i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

2. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
ADMINISTRATORI

Nr. 1453 Prot.

Tiranë, më 30.07 2022

Lënda: Kërkesë për miratimin e një shtese në rregulloren e rekrutimit të personelit administrativ në UST.

PROF. DR AGRON KASA

REKTOR I UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

I nderuar Z.Rektor !

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Senatit Akademik nr.66, datë 23.04.2021 “Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ të UST-së, Lëvizjet paralele për staf ndihmës akademik me karakter administrativ”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ në UST, Lëvizjet paralele për staf administrativ”, kërkoj të bëhet shtesë në Rregulloren e rekrutimit të personelit administrativ tek paragrafi, Lëvizjet Paralele, si më poshtë vijon :

Lëvizjet e brëndshme të stafit ndihmës akademik në staf administrativ (lëvizjet paralele) bëhen pa konkurim nëse plotësojnë kriteret për pozicionin e lirë. Këto lëvizje të brëndshme propozohen nga Administratori bazuar në nevojat e drejtorive dhe miratohen nga Rektori i Universiteti i Sporteve të Tiranës.

Duke ju falenderuar, për bashkëpunimin.

ADMINISTRATORE

Mirlinda GALUSHI

